VENDIM
Nr.336, datë 31.5.2006

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) Objekti me numër rendor 8, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç", Shkodër, kalon në pronësi të bashkisë së Shkodrës.

b) Objekti me numër rendor 16, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç", Durrës, kalon në pronësi të bashkisë së Durrësit.

c) Objekti me numër rendor 24, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç", Vlorë, kalon në pronësi të bashkisë së Vlorës.

ç) Objekti me numër rendor 31, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, "Shtëpia e foshnjës 0-3 vjeç", Korçë, kalon në pronësi të bashkisë së Korçës.

d) Objekti me numër rendor 26, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, "Qendra Polivalente e Zhvillimit", Sarandë, kalon në pronësi të bashkisë së Sarandës.

dh) Objekti me numër rendor 2, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, "Qendra e Zhvillimit", Tiranë, kalon në pronësi të bashkisë së Tiranës.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të hiqen nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006 të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi dhe shërbimi shoqëror që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 064, kap.1, artikull 600, 601 dhe 602, të grupit 25, titulli 064, kap.5, artikull 600 dhe 602 , të buxhetit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratuar për vitin 2006 dhe për vitet buxhetore në vazhdim.

5. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive të përmendura në pikën 1 dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha